



## **ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS**

---

# **PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2014**

## **1. HYRJE**

Gjatë vitit 2014, Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK-ja) është angazhuar në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të komunave, në ofrimin e shërbimeve të avancuara për komunat dhe në përmirësimin e performancës së tyre, në themelimin dhe fuqizimin e strukturave të reja të AKK-së dhe për një performancë financiare më të mirë. Të gjitha aktivitetet e AKK-së janë bazuar në Strategjinë e AKK-së 2011-2015 si dhe në objektivat strategjike që organet drejtuese të AKK-së i kanë përcaktuar për vitin 2014.

AKK-ja ka monitoruar dhe raportuar aktivitetet e saj. Rezultatet raportohen çdo gjysmëvjetor dhe prezantohen (i) si përmbledhje ekzekutive narrative dhe (ii) në formë të një tablele gjithëpërfshirëse në të cilën ofrohen detaje shtesë.

## **2. PIKAT KRYESORE PËR VITIN 2014**

Viti 2014 ishte një periudhë e veçantë për aktivitetet e AKK-së. Në fundvitin 2013 u mbajtën zgjedhjet lokale ku kishim 22 kryetarë të rinj nga 36 kryetarë të komunave, dhe shumicën e drejtorëve komunal kemi të rinjë në pozitë. Kësaj i shtohen zgjedhjet e përgjithshme në qershor ku edhe më pastaj kishim një 'stagnim' të jetës institucionale në funksion të hartimit të akteve ligjore.

Aktivitetet kryesore gjatë vitit:

- Fushata trajnuese për anëtarët e rinj të Kuvendeve të Komunave (me buxhet të veçantë nga SDC-ja / Janar -Shkurt)
- Konstituimi i organeve të AKK-së (Kuvendi i Përgjithshëm, Këshilli, Bordi, Kryetari dhe Kolegji) / Mars-Maj
- Ngritja e pagave për 25% për stafin politik në komuna dhe kabineti në Zyrën e Kryetarit.
- Takimi i partnerëve "Miqte e AKK-së" / Prill.
- Ndryshimin e qarkores buxhetore 2015/1, ku të hyrat vetanake komunale ndalohej të përdoshin për investime kapitale.
- Çështja e sigurimeve shëndetësore, ku komunave nuk iu mirren 8.5 milion euro.
- Ngritja e kapaciteteve të komunave në zbatim të legjislacionit të ri.

## **3. ZHVILLIMI E KONSOLIDIMI I STRUKTURAVE DHE POLITIKAVE (QËNDRIMEVE)**

Gjatë këtij viti, lobimi i AKK-së është përqendruar në çështjet me prioritet për komunat, siç janë: Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, Ligji për Pagat e Funkionarëve Publikë, Ligji për Shërbimin Civil të Kosovës, Ligji për Menaxhimin e Pyjeve, Ligji për Prokurimin Publik, Asetet Komunale dhe përfaqësimi i komunave në Bordet e NP-ve rajonale.

Krahas kësaj, AKK-ja i ka konstituar organet e saj, duke filluar nga Kuvendi i Përgjithshëm, zgjedhja e Bordit dhe konsolidimi i 12 Kolegjiumeve Profesionale të saj. Janë zgjedhur Kryesuesit e Kolegjiumeve, ndërsa Kolegjiumet i ka hartuar planet e tyre të punës dhe i kanë caktuar prioritetet e tyre për vitin 2014. Planet vjetore përfshijnë edhe fillimin e implementimit të pjesëve të caktuara të strategjive të kolegjiumeve që janë hartuar vitin e kaluar.

#### **4. LOBIMI DHE AVOKIMI**

Përkundër zgjedhjeve komunale që u mbajtën në fund të vitit 2013 dhe zgjedhjeve nacionale që u mbajtën në qershor të vitit 2014, AKK-ja ka lobuar dhe avokuar vazhdimisht për interesat e komunave në nivel qendror.

Të arriturat kryesore gjatë këtij viti ishin:

- Rritja për 25% e pagave të stafit politik të komunave dhe krijimi i kabineteve në zyrat e kryetarëve të komunave. Pagat e kryetarëve të komunave, drejtorëve komunalë dhe kryetarëve të kuvendeve komunale nuk kanë qenë në shkallë të njëjtë me obligimet dhe përgjegjësitë që ata i kanë pasur para ligjit dhe para qytetarëve. Për këtë qëllim, janë miratuar me sukses Projektligji për Pagat e Funkionarëve Publikë dhe udhëzimi administrativ që e rregullon çështjen e kabineteve të kryetarëve të komunave.
- Ndryshimin e qarkores buxhetore 2015/1, e cila kishte kufizimin që nga të hyrat vetanake komunale të ndalohej që mjetet të shkonin edhe në investime kapitale. Pas lobimit dhe avokimit të AKK-së edhe përmes Kolegjiumit kjo qarkore u ndryshua ashtu siç ishte kërkesa e komunave që tani komunat nuk kanë kufizime në orientimin e mjeteve nga të hyrat vetanake për projekte kapitale .
- Çështja e sigurimeve shëndetësore të punëtorëve komunalë, rezultojë pozitivisht falë lobimit të AKK-së dhe takimeve dhe avokimit në Ministrinë e Financave, sepse komunat nuk i kishin të planifikuara ato mjete financiare dhe buxheti ishte 8.5 milion në dëm të komunave. Këto mjete mbulohen nga buxheti qendror.
- Megjithatë, edhe vetë AKK-ja ka përfituar nga këto përpjekje, meqë kjo ka ndikuar drejtpërsëdrejti në imazhin e saj, për shkak të përbërësve të shumtë të saj (kryetarëve të komunave, drejtorëve, kryetarëve të kuvendeve), duke treguar se kjo organizatë është e aftë të llojë për përmirësime konkrete dhe të prekshme në qeverinë qendrore.

### **Treguesit e Suksesit**

#### **4.1. Financat Lokale**

**Konteksti** - Financat lokale dhe çështjet të tjera që ndërlidhen me decentralizimin financiar përbëjnë njërin nga prioritetet në angazhimet e AKK-së dhe njëkohësisht njërin nga fushat më të ndjeshme të punës së AKK-së. Gjatë vitit 2014, AKK ka arritur me sukses t'i mbrojë interesat e komunave në kuptim të ruajtjes së autonomisë financiare të komunave dhe forcimit të mëtejshëm të kapacitetit financiar të tyre.

**Të arriturat** - Lobimi i AKK-së për mbrojtjen e interesave të komunave dhe pavarësisë financiare të tyre gjatë procesit të ndryshimit të legjislacionit apo edhe miratimit të ligjeve të reja ka rezultuar me avokim të suksesshëm për komunat:

- Rritjen e pagave prej 25 % për stafin politik komunal dhe lejimin e kryetarit për angazhimin e tre punëtorëve shtesë me rastin e formimit të kabinetit të tij/saj;
- Ndryshimin e qarkores buxhetore 2015/1, e cila kishte kufizimin që nga të hyrat vetanake komunale të ndalohej që mjetet të shkonin edhe në investime kapitale;
- Marrëveshjen me nivelin qendror ku komunave iu mundësua pagesa e 8.5 milion € si obligim i komunave për kontributin mbi sigurimin shëndetësor për punëtorët e komunës.

**Impakti** - Impakti i këtyre sukseseve të arritura gjatë vitit 2014 është i dukshëm dhe do të reflektojë direkt në buxhetin dhe pavarësinë financiare të komunave. Ndikimi kryesor do të jetë në krijimin e autonomisë komunave për shpenzimin e të hyrave vetanake komunale në investime kapitale që do të ndikoj në përmirësimin e mëtutjeshëm të cilësisë së jetës së qytetarëve. Gjithashtu, 8.5 milion euro nga buxheti i komunave përdoret për projekte tjera meqë ato kjo pjesë për sigurim shëndetësor mbulohen nga qeveria qendrore.

Poashtu pritet që këto ndryshime të ndikojnë drejtpërsëdrejti në performancën e organeve komunale, sepse ngritja e pagave të stafit politik dhe krijimi i kabinetit të kryetarit të komunës do ta shtojë motivimin dhe përkushtimin dhe do ta shtojë në mënyrë indirekte efikasitetin dhe efektivitetin e ofrimit të shërbimeve.

## 4.2. Sigurimet Shëndetësore

**Konteksti** - Ligji mbi Sigurimet Shëndetësore hyn në fuqi më 2015. Sipas këtij ligji, duke filluar nga viti 2015, secili nga punëdhënësit dhe punëmarrësit në Kosovë do të paguaj nga 3.5% të pagës si kontribut në fondin e sigurimit shëndetësor. Për shkak të shkurtimeve buxhetore, komunat nuk kanë patur mundësi të paguajnë pjesën e tyre të obligimit ndaj fondit shëndetësor lidhur me punëtorët komunal.

**Të arriturat** - Pas lobimit të AKK për këtë çështje, niveli qendror ka vendosur që të mbuloj këtë obligim të komunave të Kosovës ndaj fondit shëndetësor lidhur me punëtorët komunal.

**Impakti** - Obligimi i shlyer i punëtorëve komunal ndaj fondit shëndetësor si dhe investimi i atyre mjeteve në projekte tjera komunale për interes të qytetarëve.

## 4.3. Ngritje kapaciteteve të komunave në zbatim të Ligjeve të miratuara

**Konteksti** - Janë një sërë obligimesh komunale që dalin nga legjislacioni në fuqi për nivelin lokal. Në këtë drejtim AKK ka bërë përpjekje dhe aktivitetet të parreshtura që komunat të kenë sa më shumë njohuri dhe mekanizma për përmbushjen e obligimeve të tyre ligjore në fusha të ndryshme.

**Të arriturat** - Meqenëse këtë vit kishim zgjedhjet lokale konsiderohet se shumica e anëtarëve të kuvendeve të komunave ishin të rinjë, përveç pakos së trajnimeve në fillim të vitit, janë organizuar edhe trajnimet në muajin nëntor në bashkëpunim me DEMOS-in. AKK-ja iu ka ofruar të botuara ligjet kryesore me të cilat anëtarët e Kuvendeve dhe zyrtarët e komunës duhet punuar si dhe iu ka ofruar disa dokumente të cilat i ka hartuar Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve anëtarëve të rinj të kuvendeve po ashtu edhe zyrtarëve të rinj që kanë filluar punën në komunë. Bëhet fjalë për 24 model-rregulloret komunale, udhëzuesin për dhënien në shfytëzim të pronës së paluajtshme të komunës i cili dokument është hartuar në formë të komentarit, e krejt kjo me qëllim të përkrahjes së komunave në proceset zhvillimore lokale si dhe model-rregulloren për qentë dhe macet.

Po ashtu AKK-ja vazhdimisht ka përcjell tek zyrtarët e komunave, për diskutim të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore të cilat i kanë hartuar ministritë e linjës por të cilat kanë qenë të ndërlidhura me kompetencat komunave. Bëhet fjalë për 3 projekt-strategji, 8 – projektligje dhe 23 projekt-udhëzime administrative, të cilat janë shqyrtuar nga mekanizmat e AKK-së dhe janë dhënë rekomandimet me kohë.

Është bërë rishikimi i doracakut të shkollave për qeverisje në arsim. Kryesitë e gati gjysmë kolegjiemeve janë trajnuar për e-qeverisje. Kurse, janë organizuar edhe trajnime për kalkulimin e tarifës së mbeturinave, një obligim ky i komunave në fushën e shërbimeve publike.

Poashtu është shpërndarë koncept-doracaku lidhur me procedurën dhe përmbajtjen e hartimit të planeve rregulluese në fushën e planifikimit hapësinor.

Në të njëjtën linjë, AKK-ja ka familjarizuar komunat me Ligjet e aprovuara përmes takimeve, trajnimeve e simnareve në implementimin e tyre në mënyrë sa më të mirë të mundshme.

**Impakti** - Komunat janë njoftuar vazhdimisht se cili akt ligjor ose nënligjor është në procedurë të hartimit, kur është në procedurë të diskutimit, kjo i'u ka ndihmuar komunave të jenë të informuara të planifikojnë punët e tyre rreth afatave se kur nxirret një akt i cili rregullon një çështje të caktuar po ashtu shumica e akteve iu ka lehtësuar punën e përditshme të zyrtarëve të komunave. Sidomos AKK-ja ka lobuar shumë që Ministria e Financave me kohë të bëj shpërndarjen e qarkoreve buxhetore, përdallim nga viteve tjera, ku iu dërgonin shumë afër afatit dhe nën presion të kohës nuk kishin një planifikim më të mirë të buxhetit.

Komunat janë pajisur me njohuri të krijimit të një sistemi për trajtim të qenëve dhe maceve sipas standardeve ndërkombëtare duke krijuar më shumë siguri për qytetarët. Komunat kanë një set të modeleve për hartimin e akteve të ndryshme komunale për të realizuar me përgjegjësi kompetencat e tyre komunale. Komunat do e kenë shumë me lehtë përkrahjen e iniciativave për zhvillim lokal meqë kanë në dorë një procedurë të qartë të dhënies në shfrytëzim të pronës komunale. Komunat janë fuqizuar në aspektin e menaxhimit të sistemit parauniversitar për ç'gjë janë edhe përgjegjëse sipas ligjit në fuqi. Në fushën e shërbimeve publike komunat mund të ndërtojnë një mekanizëm të qëndrueshëm të shërbimeve të mbeturinave.

## 5. PUNA E KOLEGJIUMEVE PËR SHËRBIMET KOMUNALE

AKKja, përmes dymbëdhjetë Kolegjiumeve Profesionale të saj, synon ta përforcojë bashkëpunimin midis komunave dhe t'i analizojë çështjet që janë në interes të pushtetit lokal, me një fokus të veçantë në përmirësimin e shërbimeve komunale.

Objektiv kryesor i AKK-së për periudhën raportuese ka qenë që t'i formojë dhe konsolidojë Kolegjiumet pas zgjedhjeve. Ku pas konsolidimit të tyre, të dymbëdhjetë Kolegjiumet i kanë caktuar prioritetet e punës së tyre për këtë vit, i kanë hartuar dhe miratuar planet e punës së tyre për vitin 2014 dhe i kanë caktuar prioritetet e punës dhe aktivitetet sipas orarit të takimeve vjetore. Në këtë vit, secili kolegjium i ka mbajtur nga 6 takime mesatarisht. Përndryshe, janë mbajtur 14 takime të Kryesive dhe 59 takime të Kolegjiumeve. Krahas kësaj, janë mbajtur 11 takime të Komisioneve të ndryshme për shqyrtim të legjislacionit. Si rezultat, secili Kolegjium i ka hartuar dhe aprovuar së paku dy qëndrime, të cilat pastaj janë prezantuar dhe diskutuar në nivel të organit apo mekanizmit qendror përkatës.

Në përputhje me planin strategjik të AKK-së dhe nisur nga nevoja për fuqizimin e rolit të Kolegjiumeve dhe rrjedhimisht të komunave në ushtrimin e autorizimeve dhe kryerjen e detyrave të tyre janë aprovuar Planet Strategjike të Kolegjiumit për Planifikim Hapësinor, Kolegjiumit për Inspeksion Komunal dhe Kolegjiumit për Buxhet dhe Financa

Përfaqësuesit e Kolegjiumeve të AKK-së kanë marrë pjesë në Grupet Punuese dhe Komisionet e ndryshme në nivelin qendror duke prezantuar dhe mbrojtur qëndrimet e autoriteteve lokale në Kosovë.

Kolegjiumet në përgjithësi kanë marrë nga AKK-ja mësimet dhe trajnimet e nevojshme në implementimin e ligjeve të aprovuara dhe atyre që ka lobuar me theksin për t'u ofruar shërbime qytetarëve sa më të mira dhe për të përforcuar idenë tek institucionet qendrore se për aktet ligjore që lobon AKK-ja ato implementohen konkretisht nëpër komuna sepse arsyetimi dhe nevoja ka qenë reale dhe e nevojshme.

Në vijim është paraqitur një listë e të arriturave kryesore në përmirësimin e shërbimeve të AKK-së për komunat si rezultat i punës së Kolegjiumeve.

**Kolegjiumi për Shërbime Publike** – Puna në fushën e shërbimeve publike mbetet sfidë konstante për komunat, posaçërisht kur kemi të bëjmë me menaxhimin e mbeturinave, ndërmarrjet publike dhe eficiencën e energjisë. Komunat përballen me probleme të përhershme dhe me ndërhyrje në kompetencat e tyre për menaxhimin e shërbimeve publike në këtë aspekt dhe kjo ka ndikuar në një menaxhim të dobët në komuna dhe në kompanitë përkatëse që kanë qenë të përfshira në ofrimin e këtyre shërbimeve.

Asociacioni i Komunave të Kosovës, në bashkëpunim me GIZ-MMS, ka konsideruar se diskutimi për Ligjin për Menaxhimin e Mbeturinave dhe për Ligjin për Ndërmarrjet Publike është shumë i rëndësishëm për t'i shpjeguar kompetencat dhe për ta harmonizuar legjislacionin në këtë fushë. Gjetja e një zgjidhjeje të qëndrueshme në këtë fushë pritet t'i

kontribuojë fuqizimit të komunave dhe ngritjes së inkasimit në buxhetin komunal nga mbledhja e mbeturinave si dhe një administrimi më të mirë në këtë drejtim, si premtim i vazhdueshëm që u është dhënë qytetarëve.

Asociacioni i Komunave të Kosovës në pajtim me partnerët e saj GIZ dhe DEMOS ka arritur të vendosë një bazë funksionale dhe është në vazhdim të angazhimit në arritjen e rezultateve konkrete me përfshirjen e të gjitha komunave në fushën e menaxhimit të mbeturinave komunale, sidomos në përcaktimin e modeleve të operimit për Sistemin e Integruar të Menaxhimit të Mbeturinave si dhe shpenzimeve operacionale (Tarifave) për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.

AKK-ja në bashkëpunim me Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW), Shoqatën për Energji të Ripërtrishme (SHERK) dhe Asociacionin Kosovar për Energji të Ripërtrishme dhe Energji Efiçiente (AKEREE) kanë filluar të ndihmojnë komunitetet në përgatitjen dhe aprovimin e planeve komunale për një zhvillim të qëndrueshëm dhe efiçencë të energjisë sipas direktivës evropiane për efiçencë të energjisë 2012/27/EU, ku komunitetet do të kenë një rol të rëndësishëm në kursimin e energjisë dhe shpenzimeve buxhetore sikurse është ndriçimi publik apo ngrohja e ambienteve komunale, arsimore dhe shëndetësore.

AKK ka organizuar disa takime me KEDS për të nxitur bashkëpunimin më të ngushtë në mes të nivelit komunal dhe ndërmarrjes elektroenergjetike, si në fushën e furnizimit me energji elektrike ashtu edhe në instalimin e njehsorëve elektrik.

**Kolegjiumi për Arsim** - në bashkëpunim me MASHT dhe GIZ-CDBE ka filluar puna dhe diskutimi në hartimin e “Doracakut për Qeverisjen Arsimore në Komuna” me qëllim ngritjen e qeverisjes arsimore dhe zhvillimin e kapaciteteve në nivel komunal. Ky doracak orienton zhvillimin e aktiviteteve në fushat programore në ngritjen e kapaciteteve me anë të ofrimit të programeve trajnuese për mësimdhënësit, hartimin e procedurave dhe dokumenteve për rekrutimin e stafit, mënyrës së gradimit, përshtatja e formulës së financimit dhe matja e performancës.

**Kolegjiumi për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale** - AKK-ja si anëtare e Grupeve Punuese me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale si dhe Komisionin Evropian ka punuar në realizimin e mbështetjes së komunave për një decentralizim të plotë të shërbimeve sociale në favor të Komunave. Ky decentralizim do të jetë për tre kategori sociale: a). Strehimi familjar e personat me nevoja të veçanta dhe të moshuarit, b). Vazhdimi i licencimit të punëtorëve social të cilët ofrojnë shërbime sociale familjare në të gjitha Komunitetet e Kosovës, dhe c). Mbështetja e Komunave, respektivisht Drejtoratit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Qendrave për Punë Sociale, në lidhje me përpilimin e buxhetit për kategoritë sociale.

**Kolegjiumi për Integritet Evropian** - AKK-ja në bashkëpunim me GIZ-in, ka bërë vlerësimin e procesit të Integritetit Evropian në nivel lokal ku ky vlerësim përfshin disa aspekte si kapacitetet dhe procesi i koordinimit brenda komunave, me institucionet e nivelit qendror e në bashkëpunimit me shoqërinë civile. Ky vlerësim përmirëson gjendjen ekzistuese të procesit të integritetit evropian në nivel lokal, shërbimet ndaj qytetarëve, fuqizimin e pozitës dhe rolit të Zyrtarit Komunal për Integritet Evropian dhe harmonizimit të politikave komunale në proces të integritetit evropian. Po ashtu në pajtim

me vlerësimet dhe kërkesat e dala nga procesi i integrimi evropiane në nivel komune AKK-ja ka kërkuar nga kryetarët e të gjitha komunave të Kosovës që zyrtarët komunal për integrimi evropiane të jenë pjesë e mbledhjeve të ekzekutivit komunal, me rol të veçantë në koordinimin e proceseve integruese dhe harmonizimin e legjislacionit e cila ka hasur në një reagim pozitiv nga kryetarët.

**Kolegjiumi i Zyrtarëve Ligjor** - Ky Kolegjium i ka bashkërednitur aktivitetet me të gjitha Kolegjiumet tjera, duke iu ofruar bashkëpunim sidomos në fushën juridike. Ka hartuar dokumentin Udhëzues për zbatimin e ligjit për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim dhe këmbimin e saj (të cilin dokument e ka botuar dhe iu shpërndarë të gjitha komunat në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe), pastaj ka hartuar Model-Rregulloren për qentë dhe macet, ka shqyrtuar disa Udhëzime Administrative të cilat i ka trajtuar në aspektin juridik dhe ka dhënë rekomandimet që aktet juridike të jenë në konturat e duhura sipas legjislacionit në fuqi.

Në bashkëpunim me OSBE-në, ka arritur realizimin e kërkesës, për botimin e dokumentit me 24 Model-rregullore të cilin dokument ky Kolegjium e ka hartuar para dy viteve, mirëpo këtë vit u botua nga OSBE-ja, dhe i'u është shpërndarë të gjitha komunave në gjuhët shqipe, serbe dhe turke.

## **6. QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE E AKK-së**

**Konteksti i shkurtër** - Asociacioni i Komunave të Kosovës ka si synim të vazhdueshëm ndërtimin e një sistemi të qëndrueshmërisë financiare që garanton ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe statusore të saj. Edhe pse AKK që nga themelimi deri sot është përballur më vështirësi dhe sfida të shumta të cilat kanë reflektuar direkt në qëndrueshmërinë financiare të saj. Megjithatë, AKK ka arritur që të krijoj jo vetëm një trend pozitiv në krijimin e qëndrueshmërisë financiare, por edhe në ndryshimin e perceptimit të komunave ndaj AKK-së duke rezultuar më ndërtimin e raporteve kontraktuale mirëbesuese të dyanshme.

Kjo është dëshmuar edhe në Kuvendin e Përgjithshëm të AKK-së që u mbajt në muajin Mars 2014 përmes pjesëmarrjes masive të komunave dhe anëtarësimit të komunave më shumicë serbe dhe minoriteteve tjera.

**Të arriturat gjatë vitit 2014** - Objektivi i paraparë në buxhetin e AKK për vitin 2014 është 120.000 €. Brenda periudhës referuese AKK ka realizuar mbi 100 % të objektivit të paraparë, duke mbledhur 136.564€. Ky është viti më i suksesshëm i AKK-së në mbledhjen e anëtarësisë, për herë të parë që nga themelimi, AKK jo vetëm që ka realizuar objektivin e saj, por edhe ka tejkaluar në mënyrë të dukshme. Arsyeja e këtij suksesi të AKK-së qëndron në vazhdimin e punës së mirë të administratës, konsolidimi dhe funksionaliteti i strukturave të reja të AKK pas zgjedhjeve lokale të fund vitit 2013. Arsye tjetër është edhe ndërtimi i një bashkëpunimi të shkëlqyeshëm me donatorët dhe koordinimi i aktiviteteve në raport me komunat, duke bërë kështu që të fuqizohen komunat por edhe AKK në të njëjtën kohë.



**SDC** - Si partneri kryesor në zhvillimin dhe avancimin e AKK-së ka rolin dominant në aktivitetet dhe buxhetin e AKK-së. Programi i financuar nga SDC-ja i jep më shumë hapësirë veprimi, mbulimit të aktiviteteve të AKK-së varësisht nga koha dhe nevoja për lobim për dallim nga projekte e organizatave tjera. Programi mbështetës i financave nga SDC është gjithëpërfshirës në aktivitetet e AKK-së dhe i integruar me buxhetin bazë.

Sukses tjetër në kuadër të këtij objekti llogaritet edhe puna dhe lobimi i vazhdueshëm i AKK-së më akterë të ndryshëm duke përfshirë takimet dhe vizitat e udhëheqjes së AKK-së nëpër komuna, Kolegjiunet profesionale të saj, sidomos atë për Buxhet dhe Financa më qëllim të futjes së pagesës së anëtarësisë në planifikimin buxhetor të komunave. Si rezultat mbi 20 komuna komuna tashmë kanë krijuar linjë të veçantë për pagesën e anëtarësisë në AKK, linjë kjo që është vendosur në kategorinë “Mallra dhe Shërbime”, (Kodi ekonomik “Shpenzimet e anëtarësisë”).

**Financimi nga palët e treta** - Financimi nga palët e treta nënkupton grantet e realizuara nga AKK përveç atyre të realizuara nga programi i financuar nga SDC (ku ky bashkëpunim ka filluar nga viti 2009 dhe këtë vit kontributi i SDC-së arrin në 200.000 euro). Në këtë drejtim AKK për vitin 2014 ka paraparë një buxhet në total prej €130,060 nga organizata të ndryshme financuese, si BB SAFE, NALAS, COUNCIL OF EUROPE, DEMOS, GIZ, dhe AMICI DEI BAMBINI. Në periudhën referuese, AKK ka arritur të realizoj një pjesë të grantëve të parapara, përkatësisht në këtë periudhë AKK ka nënshkruar kontratë me NALAS në shumë prej € 10,884, me AMICI DEI BAMBINI në shumë prej €2,192, me GIZ në shumë prej € 6,000. Brenda vitit 2014, AKK ka qenë në kontakt të vazhdueshëm me organizata të ndryshme dhe më këtë rast ka arritur që t'i bindë ata për realizimin e tri projekteve të rëndësishme që do të fillojnë në vitin 2015 dhe që kapin shumën rreth € 103,000.

## **7. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT**

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka parnteritet me shumë organizata të ndryshme me të cilat i bashkërendon aktivitetet ngase ndërlihen punët e përbashkëta me ta. Bashkëpunimi me parnterë, AKK-së i ka ndihmuar në realizimin e shumë projekteve që kanë përfituar komunat qoftë në fonde, përkrahje financiare në projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime punëtori, shkëmbim të përvojave etj. Poashtu ky partneritet ka ndikuar edhe në ngritjen e performancës së komunave, ngritjen e kapaciteteve, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme, plotësimin e mungesave të dokumenteve të nevojshme, bashkëpunimin mes komunave dhe bashkëpunimin mes komunave dhe organizatave të ndryshme etj.

**Miqhtë e AKK-së / takimi vjetor** - më partnerët kryesor të komunave të Kosovës të cilët merren dhe punojnë në fushën e qeverisjes lokale. Miqtë e AKK-së po funksionon si një mekanizëm shumë i rëndësishëm në bashkërendimin e aktiviteteve mes institucioneve lokale dhe organizatave partnere të tyre. Vlen të theksohet roli kryesor që luan AKK-ja në këtë koordinim të takimit dhe aktiviteteve të tyre.

- GIZ- ka ndihmuar në fushën e arsimit, duke mbajtur trajnime të ndryshme për stafin nga drejtoritë komunale për arsim, pastaj organizimin e punëtorive për hartim të dokumentave të nevojshme për drejtoritë komunale për arsim, etj.
- GIZ dhe DEMOS janë partnerë të rëndësishëm në fushën e shërbimeve publike me theks të veçantë në përcaktimin e modeleve të Menaxhimit të Mbeturinave si dhe shpenzimeve (Tarifave) për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave.
- GIZ ka filluar një projekt rajonal të efijencës së energjisë pjesë e të cilit është edhe AKK. Mbeten të shihen më 2015 efektet kryesore të angazhimit në këtë projekt.
- Konferencë senzibilizuese për parandalimin e punës së fëmijëve - ku kjo kategori është aprovuar si kategori e ndjeshme edhe në planin strategjik për vitin 2014-2016 (ILO IPEC).
- Fillimi i miratimit të pesë rregulloreve Komunale për Shëndetësi (Fuqizimi i Konceptit të Mjekësisë Familjare ) – OBSH.
- Bashkëpunim në mes të AKK-së dhe UNICEF-it në konferenca, takime, trajnime kundër dhunës në Familje, apo në përmasa gjinore i fokusuar në tri komuna pilotuese: Dragash, Gjakovë dhe Gjilan (angazhimi i ekspertizës ndërkombëtare nga UNICEF).
- Amici Dei Bambini – Draftimi i Planit Strategjik të Kolegjiumit për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale me ekspertizë, mbështetja e kategorisë së strehimit familjar (gjetjen e familjeve strehuese për komunitat), sensibilizim për mes fushatave në secilën komunë, trajnime me Qendra të Mjekësisë Familjare, Qendra për Punë Sociale, Drejtorit Komunale për SHMS si dhe trajnimi i psikologëve për të ofruar ndihmë në komunitat për rastet sociale.
- OSBE - e cila po përkrah AKK-në me organizimin e përbashkët e takimeve të disa Kolegjiumeve, dhe po i bashkërendon aktivitetet lidhur me punën e Kuvendeve të Komunave, Zyrrave Ligjore, Zyrrave për pronë e kadastër etj. Ka botuar dokumentin e hartuar nga Kolegjiumi i Zyrrarëve Ligjor, 24 model-rregulloret komunale, në tri gjuhët shqipe, sebe dhe turke.
- Në bashkëpunim me projektin e Helvetastit 'DEMOS', është organizuar trajnimi për anëtarët e Kuvendeve të Komunave për 17 komunitat jo partnere të DEMOS-it.
- AKK ka organizuar vizitën studimore në Bullgari, me DEMOS-in, për Kryesuesit e Kuvendeve të Komunave, anëtarët e Kuvendeve të Komunave dhe kryetarët e grupeve jo-formale të grave të komunave partnere të DEMOS-it, për marrjen e praktikave të mira në komunitat e Bullgarisë.
- OJQ-KS Kosova- Janë ndihmuar komunitat respektivisht stafi komunës nga sektori i Administratës, Arsimit, Shëndetësisë dhe i Teknologjisë Informative, me trajnime, punëtori, duke i ngritur kapacitete e tyre për ofrim të shërbimeve më të avancuara nga fusha e teknologjisë informative. Poashtu këtu vlen të ceket edhe Konferenca "Statusi dhe e ardhmja e e-Qeverisjes Lokale në Kosovë".

## 8. AKTIVITETE DHE SHËRBIME TJERA

**Trajnimet e anëtarëve të KK-ve** - AKK-ja ka organizuar për të tretën herë trajnimet e të gjitha Kuvendeve të Komunave të Kosovës (përfshirë edhe komunat me shumicë serbe dhe atë turke), të dalë nga zgjedhjet e nëntorit 2013. Trajnimet janë mbajtur sipas planit dhe dinamikës së paraparë më projekt duke filluar më takimin e parë trajnues më 13 Janar 2014 dhe duke përfunduar ciklin e seminareve trajnuese më datë 14 shkurt 2014. Trajnimet janë organizuar nëpër qendrat rajonale të Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe Gjilan, ku janë mbajtur nga 5 seminare për secilën modul të trajnimeve. Në të gjitha trajnimet ka pasur një pjesëmarrje mesatare afërsisht 150 anëtarë të Kuvendeve Komunale. Kjo i bie që në total numri i pjesëmarrësve në të gjitha takimet ka qenë diku rreth 6750 veta.

**Funksionimi i strukturave të AKK-së** - Me angazhimin e vetë Asociacioni i Komunave të Kosovës në këtë gjashtë mujor ka kryer obligimet statutare të funksionalitetit të strukturave të veta. Menjëherë pas zgjedhjeve lokale kemi mbajtur takimin e Këshillit të Kryetarëve (23 janar 2014) për përgatitjen e Kuvendit. Pastaj është mbajtur një takim i Kuvendit të Përgjithshëm, nga ku është zgjedhur Bordi dhe Kryetari i AKK-së dhe i cili mënjeherë ka nisur punën dhe deri më tani ka mbajtur gjashtë takime për përcaktimin e qëndrimeve për çështje të caktuara.

**Komunikimi** - Asociacioni i Komunave të Kosovës vazhdoi edhe këtë gjashtëmujor të mbaj kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunat. Në këtë periudhë tek komunat janë dërguar mbi 120 shkresa të ndryshme, njoftime, raporte, kthim përgjegjje, projekt-ligje, projekt-rregulloret, rekomandime etj.

Këtë vit AKK ka hapur edhe faqen e vetë në 'Facebook' ku aty postohen gjitha lajmet dhe aktivitetet e saja e ku shikueshmëria e secilit postim shkon në qindra 'pëlqyes'.

Duke zhvilluar transparencën, në uebfaqen e AKK-së janë vendosur vazhdimisht gjitha publikimet dhe broshurat e përgatitura nga AKK-ja dhe disa nga partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë derisa përmes zyrtarit për TI mirëmban në baza ditore uebfaqen e vetë.

Në anën tjetër uebfaqja e AKK-së gjatë këtij viti (deri më 8 dhjetor 2014) është klikuar nga 4938 kompjuterë, nga të cilët 60.6 % e tyre janë vizitorë të rinjë ndërsa 39.4% janë vizitorë të rregulltë. Gjatë këtij viti janë shfletuar 27.663 faqe derisa 3 minuta e 8 sekonda është mesatarja e qëndrimit në uebfaqe për një klikim.

Po ashtu me nxjerrjen e publikimit peroidik, të vetmin për pushtetin lokal, AKK-ja përgatit, shtyp dhe shpërndan Buletinin e vetë në baza dymujore, kështu që në këtë periudhë janë shtypur gjashtë Buletine. Poashtu AKK-ja ka punuar në forcimin e imazhit të vetë qoftë edhe përmes produkteve identifikuese apo publikimeve tjera.